

Skender ZHITIA

**PËRGATITJA PSIKO-FIZIKE DHE EDUKIMI USHTARAK I
LUFTËTARËVE TË UÇK-së NË ZONËN OPERATIVE TË LLAPIT
(1998-1999)**

Abstrakt:

Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK), si organizatë politike dhe ushtarake, ishte rezultat i organizimeve të fshehta patriotike në krye me LPK-në, e cila çlirimin e Kosovës nga pushtimi gjenocidar i Federatës Jugosllave (serbo-malazeze) e shihte përmes luftës së armatosur.¹ UÇK, gjatë organizimit, mobilizimit, përgatitjes dhe kalitjes për beteja, një ndër sfidat kryesore kishte përgatitjen psiko-fizike dhe edukimin e luftëtarëve. Për këtë qëllim pati angazhime të të gjitha niveleve komanduese dhe udhëheqëse për të përgatitur luftëtarë (ushtarë dhe eprorë) dhe njësite të stërvitura dhe të gatshme për luftën guerile dhe frontale kundër forcave serbe. Përkundër vështirësive, përgatitja e luftëtarëve dhe e njësiteve u realizua me përpjekje maksimale. Kjo u dëshmuar në betejat mes forcave të UÇK-së në Zonën Operative të Llapit (ZOLL) dhe atyre serbe. Masat që u ndërmorën për hartimin e plan-

¹ Bedri Islami, “E fshehta e hapur e Kosovës”, Prishtinë, 2001; Gafurr Elshani, “Ushtria Çlirimtare e Kosovës-dokumente dhe artikuj”, botimi i tretë, “Zëri i Kosovës”, Prishtinë, 2003; Xhavit Haliti: “Si e bëmë UÇK-në”, “Zëri”, Prishtinë, shkurt 2001-janar 2003. Intervista është botuar në *Libri i Lirisë*, Prishtinë, “Zëri”, 2003, f. 32; Burim Etemaj: “Flet Ramadan Avdiu, veprimtar i hershëm i çështjes kombëtare”, “Epoka e re”, Prishtinë, 24.04.2004; Emrush Xhemaili: “20 vjet veprimtari”, Prishtinë, 2002, faqja e internetit: www.lpk-kosova.com, data e leximit 18.06.2006; Skender Zhitia: “*Ushtria Çlirimtare e Kosovës - Zona Operative e Llapit*”, Instituti i Historisë-Prishtinë, ribotim, 2023 (Më tej: Zhitia UÇK-ZOLL).

programeve, elaborateve dhe manualeve trajnuese për ndërtimin e poligoneve të ndryshme stërvitore, planifikimin, organizimin dhe realizimin e trajnimeve nga niveli i Shtabit të Përgjithshëm, Shtabit të Zonës, brigadave dhe deri te njësitet në nivel skuadre, janë objekt trajnimi në këtë punim.

Fjalë kyçe: *Kosova, UÇK, ZOLL, luftëtarë, trajnim.*

Qëllimi i përgatitjeve psiko-fizike dhe edukimit ushtarak të luftëtarëve

Gjatë luftës çlirimtare në Kosovë (1998-1999), si në të gjitha zonat tjera, edhe në Zonën Operative të Llapit (ZOLL) ndër detyrat dhe përgjegjësitë më sfiduese në përmbushjen e misionit të UÇK-së ishte përgatitja psiko-fizike dhe edukimi ushtarak i luftëtarëve. Veç mungesës së kapaciteteve të mjaftueshme në infrastrukturën e trajnimit, sfidues ishte fakti se luftëtarët (vullnetarët) e UÇK-së në përqindje të madhe i takonin brezave të rinj që nuk kishin njohuri elementare të artit luftarak. Ky problem solli vështirësi e pengesa në ngritjen dhe përgatitjen e luftëtarëve për beteja. Megjithatë, kjo ishte dukuri e përditshme në kuadrin e vlerave dhe të etikës së luftëtarit në ZOLL. Prandaj, ZOLL, për të përmbushur misionin, duhej të përgatiste luftëtarët dhe njësitet për t'i mbajtur në gjendje gatishmërie për betejat e ardhshme. Për të arritur këtë qëllim duhej planifikuar, organizuar dhe realizuar stërvitjet ushtarake për përgatitjen e luftëtarëve dhe udhëheqësve komandues.²

Përmes edukimit dhe stërvitjes fizike të luftëtarëve ndërtohej kultura e bashkëpunimit, e besimi, kompetenca, si dhe sigurohej aftësia e njohuria thelbësore, të cilat rezultonin në gatishmërinë e luftëtarëve dhe të njësiteve. Për t'u arritur ky synim, të gjithë komandantët dhe udhëheqësit në ZOLL ishin përgjegjës që të komandojnë, drejtojnë personelin dhe menaxhojnë pajisjet për të pasur ushtarë, udhëheqës dhe njësite të stërvitura dhe të gatshme për të përmbushur misionin e tyre. Nisur nga kjo përgjegjësi, objektiv i

² Rustem Mustafa (Komandant i ZOLL-it) intervistë me autorin, Prishtinë, 1 korrik 2024; Kadri Kastrati (zëvendëskomandant i ZOLL-it), intervistë me autorin, Prishtinë, 3 korrik 2024; Nuredin Ibishi (shef i Shtabit të ZOLL-it, intervistë me autorin, Prishtinë, 3 korrik 2024; Muhamet Latifi (komandant i Mbrojtjes Civile në ZOLL), intervistë me autorin, Prishtinë, 30 korrik 2024.

stafeve udhëheqëse dhe komanduese ishte përgatitja psiko-fizike e luftëtarëve dhe njësiteve mbi bazën e standardeve të hartuara për detyrat individuale dhe kolektive. Ndërsa detyrë e stafeve drejtuese të stërvitjeve ishte të siguroheshin se nga luftëtarët po përvetësonin njohuritë për të kryer detyrën funksionale si individuale ashtu edhe kolektive (brenda njësitit).³ Synimi ishte përgatitja e luftëtarëve dhe e njësiteve për të qenë të afta dhe të gatshme të realizojnë e mbështesin me sukses detyrat e ngarkuara si dhe kërkesat e operacioneve të luftës. Pra, përmbushjen e misionit dhe betimit të luftëtarit të UÇK-së.⁴

Referuar definicioneve apo doktrinae ushtarake, arsimimi dhe stërvitja janë procese përmes të cilave arrihet zhvillimi dhe përmirësimi i aftësive dhe shkathtësive të personelit ushtarak në rolet dhe detyrat e tyre përkatëse brenda njësitit ushtarak. Arsimitimi ushtarak, si proces i tërësive të njohurive që jepen apo përfitohen përmes programeve në shkolla ushtarake, në gjendje lufte ishte i pamundur. Megjithatë, kjo mangësi plotësohej përmes stërvitjeve dhe kurseve të ndryshme që organizoheshin me qëllim që luftëtarët e UÇK-së të përvetësonin aftësi të ndryshme luftarake.⁵ Gjatë stërvitjeve, veçmas gjatë ligjëratave, luftëtarët dhe udhëheqësit e ardhshëm mësonin dhe edukoheshin rreth formësimit të personaliteteve të tyre me vlera të larta njerëzore dhe ushtarake. Ata, në proces e sipër, e kuptonin se besnikëria,

³ Ismail Revuçi (Komandant i Batalionit II në Brigadën 151 “Zahir Pajaziti” të ZOLL-it), Ajet Potera (komandant i Batalionit I në Brigadën 151 “Zahir Pajaziti” të ZOLL-it), Zeqir Berisha (komandant i njësitit “Ulpiana 48” të Brigadës 151 “Zahir Pajaziti”), Agron Berisha (pjesëtar i ekipit trajnues në Konushefc tek njësi “Ulpiana 48, intervistë me autorin, Prishtinë, 10 gusht 2024; Refik Jashari (komandant i Batalionit I në Brigadën 152 “Shaban Shala” të ZOLL-it), Musa Jakupi (komandant i njësitit të artilerisë në Brigadën 152 “Shaban Shala” të ZOLL-it), intervistë me autorin, Prishtinë, 12 gusht 2024.

⁴ Rregullore e përkohshme, Organizimi i jetës së brendshme në ushtri, kreu I, pika I. Betimi ushtarak, “Betimi ushtarak është një akt solemn, një ngjarje e shënuar në jetën e çdo ushtari me vlera të mëdha njerëzore e kombëtare, morale dhe politike”. Për më shumë shih Krasniqi, *Kthesë e madhe*, 263. Teksti i betimit: “Unë, ushtari i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, betohem se do të luftoj për çlirimin e tokave shqiptare dhe bashkimin e tyre. Do të jem përherë ushtar besnik, luftëtar i denjë i lirisë, vigjilent, guximtar dhe i disiplinuar, i gatshëm që në çdo kohë pa kursyer as jetën time të luftoj për t’i mbrojtur interesat e shenjta të atdheut. Nëse shkel këtë betim, le të ndëshkohem me ligjet më të ashpra dhe nëse tradhtoj, qof të humbur gjaku im. Betohem, betohem, betohem”.

⁵ Manual i NATO-s, Public Diplomacy Division NATO 1110 Brussels, Belgium, NATO, 2006, 331-341.

detyra, respekti, shërbimi vetëmohues, nderi, integriteti dhe guxim personal, janë vlera të domosdoshme për një luftëtar dhe komandues ushtarak. Këto vlera i mësonin në detaje gjatë stërvitjeve dhe edukimit fillestar, dhe që aty e tutje mishëroheshin me to në jetën dhe aktivitetin e përditshëm.⁶

Luftëtarët shfaqnin besnikërinë e vërtetë ndaj Kosovës, UÇK-së, njësitit të tyre ushtarak dhe bashkëluftëtarëve. Ata përmbushnin detyrat e tyre siç duhej: si individ dhe si pjesëtar njësi. Gjithashtu, mirëqenien e kombit, ushtrisë dhe vartësve të tyre, e vendosnin para mirëqenies personale. Ata përgatiteshin për të trajtuar të tjerët me dinjitet dhe respekt. Nderin e jetësonin me vlerat ushtarake dhe zhvillonin shprehinë e të qenit i ndershëm. Guximi personal ishte argument i shkallës së edukimit dhe trajnimit përball frikës, rrezikut dhe vështirësive fizike e morale.⁷

Qendra e trajnimit në Zabërgjë (6 qershor - 13korrik 1998)

Dalja publike e ZOLL-it në Zabërgjë të Mitrovicës, më 6 qershor 1998, shënon një sukses të ri të luftës çlirimtare të Kosovës të udhëhequr nga UÇK-ja.⁸ Në këtë fazë fluksi i madh i luftëtarëve vullnetarë për t'u rreshtuar në radhët e UÇK-së ishte përtej mundësive të infrastrukturës së banimit, akomodimit dhe trajnimit. Prandaj rreth rekrutimit dhe mobilizimit në radhët e UÇK-së kërkoheshin përcaktimi i kriterëve bazë për t'u pranuar pjesëtar i UÇK-së. Kriteret më të rëndësishme ishin: mosha, gjendja shëndetësore, e kaluara personale dhe familjare, posedimi i armatimit dhe i njohurive për fushën ushtarake.⁹ Rreth fillimeve të daljes publike të ZOLL-it, Rustem Mustafa, komandant i ZOLL-it, në diskutim e sipër thekson: *“Pas daljes publike në fshatin Zabërgjë, ndër prioritetet e mia për realizimin e strategjisë së Zonës, përveç shtrirjes dhe zgjerimit, ishte përgatitja psiko-fizike dhe edukimi i luftëtarëve vullnetarë, të cilët çdo ditë i shtonin radhët tona. Isha i vetëdijshëm për rrethanat në të cilat po organizoheshim dhe se ky prioritet*

⁶ Ismajl Revuçi, Ajet Potera, intervistë me autorin, Prishtinë, 10 gusht 2024; Refik Jashari, intervistë me autorin, Prishtinë, 12 gusht 2024.

⁷ Rustem Mustafa, intervistë me autorin, Prishtinë, 1 korrik 2024.

⁸ Zhitia UÇK-ZOLL, 35, 122, 129.

⁹ Kadri Kastrat, intervistë me autorin, Prishtinë, 3 korrik 2024; Muhamet Latifi, intervistë me autorin, Prishtinë, 30 korrik 2024.

*arrihej përmes mësimi, edukimit dhe disiplinës, e cila do të vijë si rezultat i këtyre dy elementeve. Prandaj, që në fillim këtë përgjegjësi e delegova me kompetencë te Kadri Kastrati, i cili në vazhdim, së bashku me Nuredin Ibishin, Idriz Shabanin dhe luftëtarët e ngritur në nivele komanduese, arritën të krijonin një sistem të lartë rreth planifikimit, organizimit dhe realizimit të përgatitjes së luftëtarëve për betejat në vazhdim”.*¹⁰

Kështu, duke pasur parasysh se, çlirimi i atdheut varej nga aftësia e forcave ushtarake, nga organizimi dhe përgatitja në përgjithësi, në Zabërgjë, në Qendrën e Trajnimit, në objektin e shkollës fillore “Riza Voca”, filloi faza përgatitore e luftëtarëve, procesi i edukimit dhe trajnimit, përmes të cilit përcillej domosdoshmëria për aftësimin e çdo ushtari, njësi dhe komande për kryerje me sukses të veprimeve luftarake. Në kuadër të këtij qëllimi, me një vullnet të pashoq dhe profesionalizëm vendosen hapat e parë drejt krijimit të qendrës së parë stërvitore të UÇK-së në ZOLL, qendër e cila nxori komanduesit e parë. Njëherazi u bë hartimi i elaborateve e plan-programeve të para, të cilat më vonë gjatë zhvillimit të luftës dhanë rezultate të larta kundër forcave serbe.¹¹

Për arritjen e nivelit të gatishmërisë fizike, psikike dhe të disiplinës, përveç hartimit të plan-programeve të mësimi dhe edukimit të ushtarëve të UÇK-së dhe të Mbrojtjes Civile (MC) në ZOLL, ishin hartuar edhe elaborate, si i rojës së objektit të bazimit të ushtrisë së Nënzonës së Llapit.¹² Përmes elaborateve rregullohej jeta e brendshme në qendrën e stërvitjes, objektet e pushimit, fjetoret dhe detyrat e rojës si dhe orari ditor. Orari fillonte prej zgjimit në ora 06:00 të mëngjesit dhe zgjaste deri në pushimin e natës (fjetjes),

¹⁰ Rustem Mustafa, intervistë me autorin, Prishtinë, 1 korrik 2024.

¹¹ Nuredin Ibishi (shef i Shtabit të ZOLL-it, intervistë me autorin, Prishtinë, 3 korrik 2024. Luftëtarët e parë, të cilët i filluan dhe i kryen me sukses stërvitjet, ishin: Selim Haziri, Shukri Ismaili, Refik Jashari, Vllaznim Maçastena, Sheqir Bunjaku, Çelë Gashi, Nexhat Ibrahim, Xhevat Hyseni, Ali Mehmeti, Skënder Beka, Sevdaim Ramadani, Bedri Bajrami, Gyner Murati dhe Shefki Munishi. Pas përfundimit të stërvitjes së kësaj gjenerate dolën dy komanduesit e parë, të cilët do të jenë pjesë e udhëheqjeve të stërvitjeve në vazhdim, Vllaznim Maçastena dhe Sevdaim Ramadani. Për më shumë shih: *Ushtria Çlirimtare e Kosovës - Zona Operative e Llapit*, ribotim i Institutit të Historisë “Ali Hadri”, 2023, 140.

¹² *Arkivi i Institutit të Historisë-Prishtinë*, Fondi: Dokumente të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës - Zona Operative e Llapit 1998-1999, kutia 1. (Më tej: *AIHP. F.UÇK-ZOLL 1998-1999. Kutia 1*), Elaborati i rojës së objektit të bazimit të Ushtrisë së Nënzonës së Llapit, 05.08.1998.

në orën 22:00.

Gjatë kësaj kohe, nga ora 06:10-06:50 realizohej gjimnastika e mëngjesit, ku luftëtarët nën përkujdesjen e oficerëve përgjegjës kryenin ushtrimet fizike (trupore-kondicionale), pastaj nga ora 07:00-08:00 shpërndahej mëngjesi dhe nën mbikëqyrjen e stafit kujdestar kryenin pastrimin e objekteve, dhomave të gjumit, oborrit etj. Në ora 08:00 organizohej rreshtimi. Gjatë rreshtimit realizohej kontrolli i higjienës personale të luftëtarëve, pastaj nën intonimin e himnit realizohej ngritja e flamurit dhe në fund lexoheshin urdhrat ditorë. Nga ora 08:10-12:00, sipas planit të mësimit dhe edukimit të luftëtarëve, kryheshin stërvitjet taktike në terren. Nga ora 12:00-14:00 shpërndahej dreka dhe shfrytëzohej pushimi. Nga ora 14:00-18:00 realizoheshin stërvitjet taktike në terren. Nga ora 18:15-19:00 organizohej mësimi teorik, delegimi i detyrave dhe parapërgatitjeve të eprorëve-komanduesve për ditën pasuese. Nga ora 19:10-20:00 shpërndahej darka, ndërsa nga 20:00-22:00 ishte kohë e lirë, e cila shfrytëzohej për diskutime, komentime, organizime dhe lexim të materialit teorik rreth stërvitjeve para pushimit të natës (fjetjes).¹³ Gjithashtu, për arritjen e nivelit të gatishmërisë fizike, psikike dhe të disiplinës, përveç plan-programeve, elaboratit të rojës dhe orarit ditor, pranë çdo qendre të stërvitjes dhe trajnimit ishin ndërtuar (improvizuar) poligone të ndryshme me pengesa të stërvitjes dhe kalitjes fizike.¹⁴

Fillimisht, luftëtarët (ushtarët dhe eprorët), gjatë ligjëratave teorike mësonin rregullat si të luftonin forcat kundërshtare, si nuk do të dëmtonin luftëtarët e forcave kundërshtare që dorëzoheshin, si t'i çarmatosnin dhe t'i dërgonin tek eprorët e tyre, si të mos i vrisnin ose torturonin të ndaluarit gjatë luftës, si t'i mblidhnin dhe të kujdeseshin për të plagosurit bashkëluftëtarë apo të forcave kundërshtare, si nuk do duhej të sulmonin personelin, objektet apo pajisjet mjekësore, si të trajtonin civilët me humanizëm (njerëzisht), si nuk do duhej të vidhnin, si duhej të respektonin pronën dhe pasurinë private, si të parandalonin shkeljen e Ligjit të Luftës dhe si duhej me respekt të trajtonin të vdekurit. Ndërsa, udhëheqësit e ardhshëm mësonin parimet kryesore të udhëheqësit, si: njohja e vetes, njohja e punës së tyre, të qenit

¹³ Zhitia UÇK-ZOLL, 131.

¹⁴ Kadri Kastrat, Nuredin Ibishi, intervistë me autorin, Prishtinë, 3 korrik 2024.

shembull, kujdesi për ushtarët dhe të tjerët, komunikimi me ushtarët, edukimi personal dhe i personelit, pajisja e vartësit, motivimi i ushtarëve, pranimi i përgjegjësisë dhe zhvillimi i punës në grup.¹⁵

Përmbajtja e ligjëratave, temave teorike dhe praktike të zbërthyer nga plan-programet në terren ishin të ndryshme, si: ushtrimet taktike, rreth armatimit dhe mësimi për qitje, qitjet me armë kalibrash të ndryshëm dhe sipas specialiteteve dhe ngarkesës, stërvitjet e xhenios, aftësimi për shëndetësi, rregullore rreshtore, rregulloret e përgjithshme të UÇK-së, stërvitja fizike, bazat e mirëmbajtjes dhe kontrollimi periodik i mjeteve materialo-teknike.¹⁶

Brenda ushtrimeve taktike, temat të cilat ligjëroheshin ishin: “Ngarkimi dhe shfrytëzimi i pajisjes dhe i armatimit”, “Orientimi në tokë dhe ecja sipas azimitit”, “Vëzhgimi në luftë”, “Lëvizja e ushtarit në luftë”, “Ushtari në sulm”, “Ushtari në mbrojtje”, “Lufta e afërt me mjetet e blinduara”, “Mbrojtja kundërajrore me armatimin e këmbësorisë”, “Ushtrimet për verifikimin e gatishmërisë luftarake, mjetet dhe mënyra e mbajtjes së ndërlidhjes në luftë”. Brenda ushtrimeve rreth armatimit dhe mësimi për qitje temat të cilat ligjëroheshin ishin: “Pushka (pushka M-48)”, “Pushka gjysmautematike”, “Pushka automatike (M.70 dhe M.76A)”, “Automatikët”, “Pushkëmitralozat”, “Mortajat e dorës dhe topi pa lëkundje 76 mm”, “Mjetet për vëzhgim dhe shënjestrim natën”, “Revolet dhe revolet automatike”, “Bombat e dorës dhe bomba e dorës kumulative”, “Minahedhësi (MH) 60 mm”, “Çaktimi i largësisë dhe vëzhgimi i fushëbetejës”, “Qitja me skuadrën MH 60 mm”, “Pushka snajper dhe qitjet”.

Brenda ushtrimeve rreth qitjes me armë sipas specialiteteve dhe ngarkesës, temat të cilat ligjëroheshin ishin: “Ushtarët”, “Qitja me armë në ngarkesë personale dhe qitja me armën kryesore në kuadër të ekuipazhit”, “Shenjëtari dhe shërbyesi në MH-60 mm - një predhë për armë”, “Shenjëtari dhe ndihmësi në Mbrojtësin Kundër Ajror (MKA) “Gulinov” 12,7 mm - nga tri qitje në cakun e palëvizshëm”, “Shenjëtari në mortajën e dorës”, “Qitje e

¹⁵ Refik Jashari, intervistë me autorin, Prishtinë, 12 gusht 2024; Ismajl Revuçi, Ajet Potera, intervistë me autorin, Prishtinë, 10 gusht 2024.

¹⁶ Kadri Kastrati, Nuredin Ibishi, intervistë me autorin, Prishtinë, 3 korrik 2024; Refik Jashari, intervistë me autorin, Prishtinë, 12 gusht 2024; Ismajl Revuçi, Ajet Potera, intervistë me autorin, Prishtinë, 10 gusht 2024.

një mine në maketin e tankut - caku i palëvizshëm”, “Shenjëtari me ekuipazhin e topit të palëkundshëm 82 mm - një predhë”, “Shenjëtari në armën “special” - një predhë në cak të palëvizshëm”, “Shenjëtari në pushkën snajper - tre fishekë në cak të vogël 30X30 cm të palëvizshëm në 200 m”.

Brenda ushtrimeve rreth stërvitjeve të xhenios temat të cilat ligjëroheshin ishin: “Kompleti diversant”, “Eksplodivitet dhe mjetet për ndezjen e eksplozivit”, “Minat”, “Shfrytëzimi i eksplozivit për minimin e objekteve të posaçme dhe elementeve”, “Paaftësimi i objekteve në mënyrat e ndryshme pa përdorimin e eksplozivit”, “Strehimoret për mbrojtje dhe veprim”, “Kapërcimi i pengesave të fortifikuara dhe pengesave tjera në kryerjen e detyrës”.

Brenda ushtrimeve të aftësimit për shëndetësi, temat të cilat ligjëroheshin ishin: “Pengimi dhe eliminimi i sëmundjeve ngjitëse dhe mbrojtja kundërbiologjike”, “Masat themelore higjienike për mbrojtjen e shëndetit”, “Ndihma e parë të lëndimet”, “Mënjanimi i rrezikut”, “Ngufatja dhe frymëmarrja artificiale”, “Ndihma e parë të gjakderdhjet”, “Ndihma e parë të thyerja e eshtrave dhe përkimi i nyejve”, “Ndihma e parë të lëndimi i pjesëve kryesore të trupit dhe evakuimi i të plagosurve dhe të sëmurëve”.¹⁷ Të gjitha këto ligjëratat teorike në terren ushtroheshin dhe praktikoheshin deri në perfeksionim. Pra, ishte një mësim teorik-praktik i kombinuar, përmes të cilit arriheshin rezultate të larta. Pas përfundimit të stërvitjeve me intensitet të ngjeshur, ushtarët caktoheshin në detyra të reja, respektivisht formoheshin formacione ushtarake me detyra të ndryshme taktike dhe operative.¹⁸

Qendra e trajnimit në Bajgorë (13 korrik - 15 shtator 1998)

Më 13 korrik 1998, për arsye strategjike, ngritjes së kapaciteteve luftarake respektivisht formimit dhe rreshtimit të njësiteve të reja, u vendos që ZOLL-i të kalonte nga Zabërgja në Bajgorë të Mitrovicës.¹⁹

¹⁷ AIHP. *F.UÇK-ZOLL 1998-1999. Kutia 1*, Plani dhe programi i stërvitjeve së togjeve dhe grupeve speciale të UÇK-së të Nënzonës së Llapit, 01.08.1998.

¹⁸ Kadri Kastrati, Nuredin Ibishi, intervistë me autorin, Prishtinë, 3 korrik 2024; Refik Jashari, intervistë me autorin, Prishtinë, 12 gusht 2024; Ismajl Revuçi, Ajet Potera, intervistë me autorin, Prishtinë, 10 gusht 2024.

¹⁹ Zhitia UÇK-ZOLL, 139; Kadri Kastrati, Nuredin Ibishi, intervistë me autorin, Prishtinë, 3 korrik.

Kështu, nga 15 korriku 1998, Qendra e Stërvitjes e vendosur në Shkollën Fillore “Qazim Bajgora”, filloi aktivitetin e saj në kushte shumë më të përshtatshme. Gjatë mbajtjes së ushtrimeve në këtë kohë u formuan gjashtë togje, nga tri për secilën brigadë, me nga 20-30 luftëtarë.²⁰ Në Bajgorë ishin krijuar kushtet ideale për stërvitje, të cilat dëshmonin aftësinë, gatishmërinë dhe precizitetin në cak, organizoheshin inskenime të ndryshme taktike dhe qitje demonstrative me armë kalibrash të ndryshëm.* Orari ditor i trajnimit dhe zhvillimit të jetës ushtarake pothuajse ishte i ngjashëm me qendrën stërvitore në Zabërgjë.

Luftëtarët (ushtarë dhe komandues) vazhdonin të mësonin mbi kuptimin e rolit të njeriut dhe të faktorëve të tjerë në luftë. Gjithashtu, përgatiteshin për komandim të suksesshëm me skuadrat, togjet, kompanitë dhe batalionet, stërviteshin për përgatitjen e veprimeve luftarake, për vlerësimin e shpejtë të gjendjes dhe marrjen e vendimit, dhënien e urdhrave, udhëheqjen me njësitet etj., dhe të zhvilloheshin në personalitet të

²⁰ Refik Jashari, intervistë me autorin, Prishtinë, 12 gusht 2024; Ismajl Revuçi, Ajet Potera intervistë me autorin, Prishtinë, 10 gusht 2024; Më 18 korrik 1998, në shkollën e Bajgorës u mbajt mbledhja e formimit-zyrtarizimit të Shtabit të ZOLL-it. Takimi u udhëhoq nga komandant Rustem Mustafa. Pjesëmarrës ishin Kadri Kastrati, Nuredin Ibishi, Latif Gashi, Sejdi Rama, Avdi Kiçmari, Muhamet Latifi, Skënder Murati dhe Hamit Hamiti. Në takim u vendos (bëhet publik): 1. Shtabit i ZOLL-it: komandant i ZOLL-it, Rustem Mustafa, zv.komandant, Kadri Kastrati, komandant i M. Territoriale, Muhamet Latifi, shef i Shërbimit Informativ, Latif Gashi, shef i Logjistikës, Hamit Hamiti, shef për Moral dhe Politikë, Fatmir Humolli, shef i Sektorit të Financave, Avdi Kiçmari, shef i Sektorit për Informim Publik, Sejdi Rama, shef i Sektorit të Shëndetësisë, Skënder Murati. 2. Formimi i Brigadës së Parë dhe të Dytë (më vonë u quajtën Brigada 151 “Zahir Pajaziti” dhe 152 “Shaban Shala”, si dhe emërimi i komandantëve. komandant i Brigadës së Parë, Nuredin Ibishi dhe komandant i Brigadës së Dytë, Idriz Shabani. 3. Formimi i Policisë Ushtarake dhe Njësitit Speciale (njësi e brigadës së dytë); Rustem Mustafa, Kadri Kastrati, Muhamet Latifi, Sejdi Rama, Avdi Kiçmari, Ismail Revuçi, Refik Jashari, Ajet Potera, Musa Jakupi, bashkëbisedim me autorin, korrik-gusht 2024. Për më shumë shih: librin Ushtria Çlirimtare e Kosovës - Zona Operative e Llapit, ribotim i Institutit të Historisë “Ali Hadri”, 2023, 140.

* Stërvitjet në këtë kohë udhëhiqeshin nga Kadri Kastrati, Nuredin Ibishi, Idriz Shabani, si dhe luftëtarët e ngritur në nivel komandues, si: Ismail Revuçi, Naser Hyseni, Ajet Potera, Refik Jashari, Rifat Maloku, Shefqet Berisha, Musa Jakupi, Refik Shala (ishte nga Gjilani), Bashkim Qerimi, Ramë Zhegrova dhe Tefik Fazliu.

vetëdijshëm, moralisht të fuqishëm dhe psiko-fizikisht të shëndoshë, iniciatorë, të shkathtë dhe trima në situata të paparashikueshme.

Në këtë kohë, për dallim nga Qendra Stërvitore në Zabërgjë, në Qendrën Stërvitore në Bajgorë, ZOLL-i kishte bërë një avancim në zhvillimin e plan-programeve më të reja dhe të avancuara të stërvitjeve, ku u hartuan plan-programe edhe për njësitet, togjet dhe grupet speciale të UÇK-së në Nënzonën e Llapit. Gjatë stërvitjeve të togjeve dhe grupeve speciale shpjegoheshin “Ushtrimet taktike dhe veprimet speciale”, “Armatimi me mësimin e qitjes”, “Ushtrimet e xhenios”, “Ushtrimet për shëndetësi” dhe “Ushtrimet fizike dhe alpinizëm”.²¹

Përmes këtyre plan-programeve, të zbërthyera deri në njësi mësimore, luftëtarët e UÇK-së merrnin leksione mbi tema të ndryshme dhe të rëndësishme në ngritje të aftësive të tyre psiko-fizike. Kështu, brenda “Ushtrimeve taktike” dhe veprimet speciale temat që ligjëroheshin ishin: “Shërbimet informative dhe kundërinformative”, “Orientimi në tokë sipas azimutit”, “Leximi dhe shfrytëzimi i hartës topografike”, “Vëzhgimi”, “Lëvizja e ushtarit në luftë”, “Ushtari në sulm”, “Ushtari në mbrojtje”, “Lufta e afërt me mjetet e blinduara”, “Mbrojtja kundërajrore me armët e këmbësorisë”, “Objektet themelore për veprime diversante”, “Përgatitja e diversantëve, zënia robër dhe sulmi në personalitete, grupet diversante (GD) në kryerjen e veprimeve diversante në elementet e caktuara të vendkomandës”, “GD në kryerjen e diversioneve në objektet e komunikacionit hekurudhor”, “GD në kryerjen e diversioneve në objektet e komunikacionit rrugor”, “GD në kryerjen e diversioneve në objektet e komunikacionit ajror”, “GD në kryerjen e diversioneve në sistemet e ndërlidhjes dhe informacionit”, “GD në kryerjen e diversioneve në largësi”, “GD në kryerjen e diversioneve në objektet e ekonomisë ushtarake”, “GD në kryerjen e diversioneve në një nga elementet e rreshtimit luftarak të armikut”, “GD në veprimet kundër diversante”, “GD në kryerjen e veprimeve diversante në më shumë objekte në territor përkohësisht të okupuar”, “Bazimi dhe mbijetesa e diversantëve”, “Mjetet për mbajtjen e lidhjes (ndërlidhjes)”, “Ushtrimet për verifikimin e gatishmërisë luftarake”.²²

²¹ AIHP. F.UÇK-ZOLL 1998-1999. Kutia 1, Plani dhe programi i stërvitjeve së togjeve dhe grupeve speciale të UÇK-së të Nënzonës së Llapit, 01.08.1998.

²² AIHP. F.UÇK-ZOLL 1998-1999. Kutia 1, Plani dhe programi i stërvitjeve së togjeve dhe

Thelbësorja në përgatitjen e luftëtarit të lirisë ishte rreth përdorimit të armëve që kishin në posedim. Kjo arrihej brenda ushtrimeve “Armatimi me mësimin e qitjes”, ku temat që ligjëroheshin ishin: “Bazat themelore të mësimin të qitjes”, “Caktimi i largësisë deri te caku”, “Pushka”, “Pushkëmitralozët dhe automatikët”, “Mitralozi 7,9 mm M. 53 dhe kalibri 12.7 mm”, “Mitralozi 7.62 mm PKT”, “Mortaja e dorës “150”, “500” dhe M. 57”, “Mortaja 60 mm”, “Topi pa dridhje”, “Trombloni me minat tromblonike”, “Bombat dhe bombat e dorës kumulative”, “Revolet automatike me shurdhues krisme dhe pa të”, “Mjetet për vëzhgim dhe shënjestrim - natën”, “Pushkët snajper”, “Qitjet me armë”, “Mbajtja dhe mirëmbajtja e armatimit dhe municionit”.²³

Një nga fushat që kërkonte përkushtim të shtuar rreth përgatitjes së luftëtarëve ishte ajo e xhenios. Brenda ushtrimeve të xhenios, temat që ligjëroheshin ishin: “Kompleti diverziv”, “Eksplziv dhe mjetet për ndezjen e eksplozivit”, “Djegoret diversante”, “Minat”, “Përdorimi i eksplozivit për rrëzimin”, “Rrënimi i elementeve të caktuara dhe objekteve”, “Paaftësimi i objekteve në mënyra të ndryshme pa përdorimin e eksplozivit”, “Ushtrimet me mjetet eksplozive luftarake”, “Strehimoret”, “Transhetë për veprim dhe mbrojtje”, “Kalimi i pengesave të fortifikuara”, “Mjetet luftarake djegëse dhe përdorimi në diversione”.²⁴

Gjendja shëndetësore e luftëtarëve ishte parësore, prandaj atyre çdo ditë iu jepeshin shpjegime dhe këshillime mjekësore. Ky objektiv arrihej brenda ushtrimeve për shëndetësi, ku temat që ligjëroheshin kryesisht ishin: “Pengimi dhe eliminimi i sëmundjeve ngjitëse dhe mbrojtja nga helmet kimike-biologjike”, “Masat themelore higjienike për ruajtjen e shëndetit”, “Ndihma e parë te lëndimet”, “Mënjanimi i rrezikut nga ngufatja dhe frymëmarrja artificiale”, “Evakuimi i të lënduarve dhe të sëmurëve”.²⁵

grupeve speciale të UÇK-së të Nënzonës së Llapit, 01.08.1998;²² Zhitia UÇK-ZOLL, 142.

²³ AIHP. F.UÇK-ZOLL 1998-1999. Kutia 1, Plani dhe programi i stërvitjeve së togjeve dhe grupeve speciale të UÇK-së të Nënzonës së Llapit, 01.08.1998.

²⁴ Ismajl Revuqi, Ajet Potera, intervistë me autorin, Prishtinë, 10 gusht 2024; Refik Jasdhari intervistë me autorin, Prishtinë, 10 gusht 2024.

²⁵ AIHP. F.UÇK-ZOLL 1998-1999. Kutia 1, Plani dhe programi i stërvitjeve së togjeve dhe grupeve speciale të UÇK-së të Nënzonës së Llapit, 01.08.1998.

Gatishmëria fizike e luftëtarit ishte domosdoshmëri për suksese në betejat luftarake, prandaj ushtrimeve fizike i kushtohej kujdes në leksionet teorike dhe praktike. Temat që ligjëroheshin kryesisht ishin: “Ushtrimet e qëndresës dhe të shpejtësisë”, “Ushtrimet e fuqisë”, “Ushtrimet e mundjes”, “Shtegu i këmbësorisë me pengesa (sistemi i NATO-s)”, “Verifikimi i aftësive fizike”.²⁶ Brenda ushtrimeve të alpinizmit temat që ligjëroheshin ishin: “Destinimi dhe shfrytëzimi i pajimit malor dhe alpinist”, “Teknika e ecjes dhe e varje-ngjitjes”, “Ngjitja e diversantit në objekte të ndryshme”, “Lëshimi me litar”, “Ngjitja e grupit diversant ngjitës dhe shpëtimi malor i të lënduarve”.²⁷

Përfundimi me sukses dhe rezultate të larta i këtyre trajnimeve (stërvitjeve) ishte një gërshetim teorik-praktik, i cili demonstrohej para stafëve drejtuese dhe komanduese të Zonës. Sipas komanduesve të ZOLL-it një demonstrim i tillë u realizua gjatë një vizite të delegacionit të Shtabit të Përgjithshëm (SHP) të UÇK-së (mesi i gushtit i vitit 1998) në Bajgorë. Me këtë rast para tyre luftëtarët (ushtarë dhe udhëheqës) demonstرونin aftësitë fizike, taktike dhe operative me njësitet të cilat ishin në trajnim. Gjatë demonstrimit u paraqit nivel i lartë i disiplinës në ekzekutimin e trajnimit (skenarëve), bashkëpunimi mes luftëtarëve brenda njësitit dhe mësymjes drejt realizimit të detyrës në operacione.²⁸

Qendrat e trajnimit në brigada, njësite speciale dhe Batalioni i Pestë Gardist (tetor 1998 - maj 1999)

Gjatë periudhës kohore tetor 1998 - maj 1999, përpos plan-programeve të theksuara më sipër, ishin hartuar plan-programe, elaborate dhe manuale të fushave të caktuara, si p.sh.: Plani dhe programi i mësimit luftarak dhe edukimit të ushtarëve të UÇK-së dhe Mbrojtjes Territoriale (MT)²⁹,

²⁶ AIHP. F.UÇK-ZOLL 1998-1999. *Kutia 1*, Plani dhe programi i stërvitjeve së togjeve dhe grupeve speciale të UÇK-së të Nënzonës së Llapit, 01.08.1998.

²⁷ AIHP. F.UÇK-ZOLL 1998-1999. *Kutia 1*, Plani dhe programi i stërvitjeve së togjeve dhe grupeve speciale të UÇK-së të Nënzonës së Llapit, 01.08.1998.

²⁸ Kadri Kastrati, Nuredin Ibishi, intervistë me autorin, Prishtinë, 3 korrik 2024.

²⁹ AIHP. F.UÇK-ZOLL 1998-1999. *Kutia 1*, Plani dhe programi i mësimit dhe edukimit luftarak dhe edukimit të ushtarëve të UÇK-së dhe Mbrojtjes Territoriale, 10.11.1998.

“Stërvitja e çifteve snajper”³⁰, “Programi i ushtrimeve dhe edukimi luftarak i njësiteve speciale të Zonës Operative të Llapit”³¹, “Plani i përgatitjes së numërorëve dhe pjesëtarëve të tjerë të baterisë së minahedhësve të kalibrit 120 mm”³², Elaborati “Vëzhgimi në njësitet e këmbësorisë”³³, manuali “Caktimi i largësisë deri te caqet dhe objektet e ndryshme në tokë”³⁴, manuali “Bazat teorike të rregullave të qitjes”, manuali i ushtrimit “Marrja në shenjë me shkrepje me armatimin e këmbësorisë dhe bashkërenditja e të gjitha veprimeve për qitje” dhe “Rregullore e raketahedhësit të dorës 64 mm m-80 (“Zola”)”.³⁵

Bazuar në këto plan-programe, elaborate dhe manuale të fushave të caktuara, trajnimet vazhdonin në qendrat e stërvitjeve të brigadave, njësiteve speciale dhe Batalionit të Pestë Gardist.³⁶ Pranë Njësitit Special të ZOLL-it “Komando”, në fshatin Llapashticë, ushtrimet i udhëhiqte Bedri Bajrami.

Ndërsa në kuadër të Brigadës 151 “Zahir Pajaziti” vepronin tri qendra trajnuese dhe atë në Konushefc, stërvitjet i udhëhiqte Fehmi Kapiti dhe Agron Berisha, në Gllamnik Bashkim Qerimi dhe në Llapashticë Bedri Ahmeti. Në kuadër të Brigadës 152 “Shaban Shala”, stërvitjet organizoheshin në katër qendra trajnuese: në Bradash i udhëhiqnin Refik Jashari dhe Musa Jakupi, në Dobratin i udhëhiqnin Rafet Llapashtica dhe Bajram Kiçmari, te Pishat i udhëhiqte Musa Jakupi, në Bajçinë Refik Jashari dhe Sami Plakolli. Në ZOLL, eprorët e Brigadës 152 stërvitnin edhe luftëtarët e Zonës Operative të Karadakut (ZOK). Ushtrimet kryheshin kryesisht në Bradash. Në kuadër të Brigadës 153 “Hyzri Talla” vepronte një qendër trajnuese dhe atë në Zllashë, në paralelen e ndarë fizike të shkollës fillore “Avni Rrustemi” të fshatit

³⁰ AIHP. F.UÇK-ZOLL 1998-1999. Kutia 1, Stërvitja e qifteve snajperik, nr. 03/05 dt. 18.01.1999.

³¹ AIHP. F.UÇK-ZOLL 1998-1999. Kutia 1, Programi i ushtrimeve dhe edukimit luftarak të njësiteve speciale të Zonës Operative të Llapit, 03. Nr. 073 datë 23. 0. 1999.

³² AIHP. F.UÇK-ZOLL 1998-1999. Kutia 1, Plani i përgatitjes së numërorëve dhe të pjesëtarëve tjerë të baterisë së minahedhësve Kal. 120 mm, dt. 26.01.1999.

³³ AIHP. F.UÇK-ZOLL 1998-1999. Kutia 1, Vëzhgimi në njësitet e Këmbësorisë, nr. 03. Nr.. 06 dt. 04.02.1999.

³⁴ AIHP. F.UÇK-ZOLL 1998-1999. Kutia 1, Caktimi i largësisë deri te caqet dhe objektet e ndryshme në tokë, 26.02.1999.

³⁵ AIHP. F.UÇK-ZOLL 1998-1999. Kutia 1, Rregullorja e raketahedhësit të dorës 64 mm M-80 “Zola”.

³⁶ ³⁶ Zhitia UÇK-ZOLL, 224.

Mramor. Stërvitjet i udhëhiqnin Musli Halimi, Nagip Murati, Emin Borovci dhe Behxhet Vitia. Eprorët e Brigadës 153 stërvitnin edhe luftëtarë të ZOK-ut. Pranë Batalionit të pestë Gardist, i cili ishte themeluar më 17 maj 1999, në fshatin Koliq, lagja e Goxhufëve, stërvitjet i udhëhiqnin Adem Shehu, Kadri Hamiti, Ramë Arifaj dhe Naser Ramadani.³⁷

Përveç me ushtarë të rinj, stërvitjet organizoheshin edhe me ushtarët e rregullt dhe ishin sistematike. Për të arritur suksese, në të gjitha këto qendra stërvitore kërkohej rend dhe përgjegjësi, andaj, për luftëtarët fillonte jeta ushtarake, e cila nënkuptonte përmbajtje të orarit ditor, plan-programeve dhe respektim të urdhrave.³⁸ Orari ditor i trajnimit dhe zhvillimit të jetës ushtarake pothuajse ka qenë i ngjashëm me qendrat stërvitore në Zabërgjë dhe Bajgorë.

Gjatë trajnimeve, përmes plan-programeve të cilat vazhdonin të zbërtheheshin deri në njësi mësimore, luftëtarët e UÇK-së merrnin mësimë përmes një gërshetimi teoriko-praktik mbi tema të ndryshme dhe të rëndësishme në ngritje të aftësive të tyre psiko-fizike.

Sipas “Planit dhe programit të mësimit luftarak dhe edukimit të ushtarëve të UÇK-së dhe Mbrojtjes Territoriale (MT)”, njohurit që merrnin luftëtarët, ushtarët dhe komanduesit, ishin përmes temave që shpjegoheshin, si: “Rregullorja e UÇK-së dhe rregulloret e përgjithshme ushtarake”, “Veprimet rreshtore”, “Armatimi i këmbësorisë me mësimet e qitjes”, “Arti taktik”, “Mësimi i xhenios”, “Mbrojtja nga mjetet nukleare-kimike, biologjike dhe stërvitja fizike”.³⁹

Brenda ligjëratave për “Rregulloren e UÇK-së dhe rregulloret e përgjithshme ushtarake” temat që ligjëroheshin ishin: “E drejta ndërkombëtare dhe konventat ndërkombëtare të luftës, të drejtat dhe detyrat e përgjithshme të personave ushtarakë”, “Puna dhe shërbimi i brendshëm në reparte, nënreparte dhe njësite”, “Sekreti ushtarak”, “Marrëdhëniet dhe raportet në forcat e armatosura”, “Alarmi dhe gatishmëria luftarake e njësitit”, “Sigurimi i objekteve dhe njerëzve”, “Disiplina ushtarake” dhe “Veprat

³⁷ Refik Jasdari, intervistë me autorin, Prishtinë, 12 gusht 2024; Ajet Potera, Ismajl Revuqi, intervistë me autorin, Prishtinë, 10 gusht 2024; Zhitia UÇK-ZOLL, 295.

³⁸ Kadri Kastrati, intervistë me autorin, Prishtinë, 3 korrik 2024.

³⁹ *AIHP. F.UÇK-ZOLL 1998-1999. Kutia 1*, Planit dhe programi i mësimit dhe edukimit luftarak dhe edukimit të ushtarëve të UÇK-së dhe Mbrojtjes Territoriale, 10.11.1998.

penale kundër forcave të armatosura”.⁴⁰ Brenda ligjëratave për “Veprimet rreshtore” temat që ligjëroheshin ishin: “Përshëndetja dhe raportet e ndërsjella në forcat e armatosura”, “Veprimet rreshtore - qëndrimet pa armë”, “Veprimet rreshtore - qëndrimet me armë”, “Veprimet rreshtore të skuadrës”, “Veprimet rreshtore të togës” dhe “Veprimet rreshtore të kompanisë - baterisë”.⁴¹ Brenda ligjëratave “Armatimi i këmbësorisë me mësimet e qitjes” temat që ligjëroheshin ishin: “Pushka dhe pushka automatike-gjysmë automatike me tromblon”, “Pushkomitralozi”, “Pistoleta gjysmautamatike dhe automatike”, “Pushka snajper”, “Bomba e dorës”, “Mortaja e dorës”, “Mjetet për vëzhgim, zbulim dhe gjuajtje të caqeve”, “Caktimi i largësisë së caktit, marrja në shënjestër, përgatitja e elementeve, marrja në shenjë dhe shkrepija”, “Qitja në caqet e palëvizshme, momentale dhe pas maskës me armatimin qitës nën ndikimin e erës dhe pa të”, “Qitja në caqet lëvizëse”, “Qitja në caqet ajrore”, “Qitja natën dhe në kushtet e kufizuara të pamjes”, “Qitja-përgatitja dhe kryerja me armatimin personal” dhe “Ruajtja dhe mirëmbajtja e armatimi”.⁴²

Brenda ligjëratave “Arti taktik” temat që ligjëroheshin ishin: “Lëvizja e ushtarit në luftë”, “Veprimet e ushtarit në luftimin mësymës”, “Veprimet e ushtarit në luftimin mbrojtës”, “Lufta e afërt me mjetet e blinduara”, “Mbrojtja kundërajrore me armatimin e këmbësorisë”, “Veprimet e skuadrës së këmbësorisë në luftimin mbrojtës dhe mësymës”, “Skuadra në rolin e patrullës vëzhguese”, “Veprimet e togës (kompanisë) së këmbësorisë në luftimin mbrojtës dhe mësymës”, “Toga (skuadra) në pritë” dhe “Orientimi në tokë dhe ecja sipas azimutit”.⁴³ Brenda ligjëratave “Mësimi i xhenios” temat që ligjëroheshin ishin: “Fortifikimi”, “Pengesat dhe mënyra e kalimit të tyre” dhe “Maskimi”.⁴⁴ Brenda ligjëratave “Mbrojtja nga mjetet nukleare-

⁴⁰ Ismajl Revuçi, Ajet Potera, intervistë me autorin, 10 gusht 2024; Refik Jashari, Musa Jakupi, intervistë me autorin, Prishtinë 12 gusht 2024.

⁴¹ *AIHP. F.UÇK-ZOLL 1998-1999. Kutia 1* Plani dhe programi i mësimet dhe edukimit luftarak dhe edukimit të ushtarëve të UÇK-së dhe Mbrojtjes Territoriale, dt. 10.11.1998.

⁴² Kadri Kastrati, Nuredin Ibishi, intervistë me autorin, Prishtinë, 3 korrik 2024; Refik Jashari, intervistë me autorin, Prishtinë, 12 gusht 2024; Ismajl Revuçi, Ajet Potera, intervistë me autorin, Prishtinë, 10 gusht 2024.

⁴³ Ismajl Revuçi, Ajet Potera, Agron Berisha, intervistë me autorin, Prishtinë, 10 gusht 2024; Refik Jashari, Musa Jakupi, intervistë me autorin, Prishtinë, 12 gusht 2024.

⁴⁴ *AIHP. F.UÇK-ZOLL 1998-1999. Kutia 1*, Plani dhe programi i mësimet dhe edukimit

kimike dhe biologjike” temat që ligjëroheshin ishin: “Armatimi nuklear, kimik dhe biologjik” dhe “Mbrojtja nga armatimi nuklear, kimik dhe biologjik”.⁴⁵ Brenda ligjëratave “Stërvitja fizike” temat që ligjëroheshin ishin: “Ushtrimet e qëndresës dhe të shpejtësisë”, “Ushtrimet e forcës”, “Sportet e mundjes”, “Shtegu i këmbësores me pengesa - NATO” dhe “Verifikimi i aftësive fizike-kondicionale”.⁴⁶

Kujdes i shtuar iu kushtojë mësimave dhe stërvitjeve të çifteve snajper. Mësimet mbi këtë specialitet i merrnin kryesisht ushtarët që ishin të ngarkuar me pushkë snajper. Leksionet që merrnin ishin përmes njëmbëdhjetë ushtrimeve: Brenda ushtrimit të parë “Destinimi dhe cilësitë luftarake”, temat që ligjëroheshin ishin: “Destinimi, pjesët kryesore, demontimi me përshkrim të pjesëve kryesore dhe demontimi i pushkës snajper (PS)”, “Destinimi, cilësitë, përshkrimi dhe përdorimi i shënjestrës optike”, “Municioni, shfrytëzimi i tij në luftë dhe përshkrimi i pjesëve”, “Pjesët rezervë, mjetet dhe pajimi”, “Ruajtja dhe mirëmbajtja e armës, e shënjestrës optike dhe municionit” si dhe “Ndalesat dhe mënyra e mënjanimit”. Brenda ushtrimit të dytë, temë e vetme e ligjërimit është “Verifikimi i precizitetit dhe saktësisë së qitje (rektifikimi) me pushkë snajper (shënjestra optike dhe mekanike) me qitje në shënjestër”. Brenda ushtrimit të tretë, temat që ligjëroheshin ishin: “Marrja e qëndrimeve (pozitave) për qitje me pushkë snajper, mbushja dhe zbrazja e pushkës snajper” dhe “Shfrytëzimi i objekteve, strehimoreve dhe mbështetjeve për qitje me pushkë snajper”.

Brenda ushtrimit të katërt, temat që ligjëroheshin ishin: “Qitja me pushkë snajper në caqet e palëvizshme dhe të vogël momentale me shfrytëzimin e shënjestrës optike”, “Mënyra e mbajtjes së pushkës në lakesë krahu, caktimi i pozitës së syrit krahas shënjestrës optike, marrja në shenjë dhe shkrepja”, “Bashkërendimi i të gjitha veprimeve për qitje me pushkë snajper në caqet e ndryshme dhe në largësitë më të mëdha se 300 metra”, “Mënyra e mënjanimit të ndikimit të erës, temperaturës dhe këndit tokësor në qitje me shënjestrën optike të PS” dhe “Qitja me maskë mbrojtëse”. Brenda ushtrimit

luftarak dhe edukimit të ushtarëve të UÇK-së dhe Mbrojtjes Territoriale, dt. 10.11.1998.

⁴⁵ Kadri Kastrati, Nuredin Ibishi, intervistë me autorin, Prishtinë, 3 korrik 2024.

⁴⁶ *AIHP. F.UÇK-ZOLL 1998-1999. Kutia 1*, Plani dhe programi i mësimit dhe edukimit luftarak dhe edukimit të ushtarëve të UÇK-së dhe Mbrojtjes Territoriale, dt. 10.11.1998.

të pestë, temat që ligjëroheshin ishin: “Qitja në caqet e lëvizshme”, “Qitja në caqet e strehuara pas maske” dhe “Qitja në lëvizje”. Brenda ushtrimit të gjashtë temë e vetme e ligjërimin ishte “Qitja në caqe ajrore”.

Brenda ushtrimit të shtatë temë e ligjërimin është “Qitja në caqet e ndryshme natën dhe në kushtet e kufizuara të pamjes me shfrytëzimin e shënjestrës optike dhe shënjestrës pasive IQ”. Brenda ushtrimit të tetë tema që ligjërohej ishte “Specifika e pozitive dhe mënyrës së qitjes në tokën kodrinore-malore”. Brenda ushtrimit të nëntë “Bazat e qitjes nga pushka snajper”, temat që ligjëroheshin ishin: “Trajektorja (rruga) e predhës me elementet e tij dhe karakteristikat e shpërndarjes së goditjeve të pushkës snajper”, “Ndikimi subjektiv i snajperistit në grupimin e goditjeve dhe saktësia e qitjes nga pushka snajper” dhe “Ndikimi i madhësisë së cakut në shpërndarjen e goditjeve nga pushka snajper”.

Brenda ushtrimit të dhjetë “Zgjedhja e detyrave të zjarrit të qiftit snajper në sulm” temat që ligjëroheshin ishin: “Pranimi i detyrës”, “Vlerësimi i kushteve për veprim me zjarr, karakterit dhe pozitës së caqeve, tokës, vendit për qitje, ndikimit të kushteve meteorologjike (pozita e diellit dhe burimeve tjera të dritës në krahasim me drejtimin e qitjes, etj.) në saktësinë e qitjes”, “Vëzhgimi i regjionit (vendit) të caqeve”, “Zbulimi, vlerësimi dhe zgjedhja e cakut për qitje”, “Caktimi i largësisë, shënjestrës dhe pikës së shënjitimit, caktimi i mënyrës dhe momentit për hapjen e zjarrit”, “Shikimi i suksesit të zjarrit, korrektura e zjarrit dhe qitja e serishme”, “Ndërrimi i vendit të qitjes në pozicionet tjera të zjarrit dhe lufta në thellësi të mbrojtjes” dhe “Qitja nën maskën mbrojtëse”.

Brenda ushtrimit të njëmbëdhjetë tema që ligjërohej ishte “Zgjedhja e detyrave të zjarrit nga qifti snajper në mbrojtje”.⁴⁷ Në ZOLL njësitet speciale në nivel të zonës dhe të brigadave kishin arritur një nivel të lartë të organizimit. Në këtë kohë, sipas “Programit të ushtrimeve dhe edukimit luftarak i njësiteve speciale të Zonës Operative të Llapit”, temat ligjëroheshin përmes tetë kapitujve të ndarë në tema dhe nëntema, si: I. Hyrja, II. Armatimi me mësimin e qitjes, III. Arti taktik, IV. Ushtrimet rreshtore, V. Ushtrimet e xhenios, VI. Mbrojtja nga mjetet NKB, VII. Ushtrimet për sanitet, VIII. Ushtrimet me stërvitje fizike dhe

⁴⁷ AIHP. F.UÇK-ZOLL 1998-1999. Kutia 1, Stërvitja e qifteve snajperik.

IX. Alpinistika.⁴⁸ Brenda kapitullit I. Hyrja, temat që u ligjëruan ishin: “Edukimi dhe përgatitja profesionale e pjesëtarëve të Njësiteve Speciale”, “Njohja e konventave dhe rregulloreve ndërkombëtare të luftës” dhe “Njoftimi me Rregulloret e UÇK-së dhe MC-së”. Brenda kapitullit II. Armatimi me mësimet e qitjes, temat që ligjëroheshin ishin: “Armatimi konvencional i këmbësorisë” dhe “Armatimi special dhe pajimi”.

Ndërsa nëntemat e temës “Armatimi konvencional i këmbësorisë” ishin: “Bazat teorike të rregullave të qitjes”, “Caktimi i largësisë deri te caku dhe vijat e caktuara”, “Pushkët: me shkrepje një nga një, gjysmautomatike dhe pushkët automatike”, “Automatikët”, “Pushkëmitralozët”, “Mitralozët”, “Revolet automatike”, “Trombloni dhe minat tromblonike”, “Mortajat e dorës “150”, “500”, M.57 “ZOLA”, “AMBRUST” etj.”, “Topi jo reaktiv 75 mm dhe 82 mm”, “Minahedhësit 82 mm dhe 60 mm”, “Bombat e dorës (klasike dhe kumulative)”, “Ruajtja dhe mirëmbajtja e armatimit dhe municionit” dhe “Qitjet nga armatimi personal dhe i përbashkët”.⁴⁹

Nëntemat e temës “Armatimi special dhe pajimi” ishin: “Pushkët snajper (me shurdhues, me shënjestrën optiko-elektronike me rreze infra të kuqe pasive, laser etj.”, “Mjetet optiko-elektronike për vëzhgim dhe qitje: dylbitë e ditës dhe natës, shënjestrat optiko-elektronike për qitje ditën dhe natën, laserët etj.”, “Armët e ftohta”, “Mjetet diversante: minuese-eksplorative, nukleare, helmet kimike, biologjike, mjetet djegëse etj.”, “Mjetet aeronautike (aeroplanët transportues të armatosur, aeroplanët për depërtim, furnizim dhe evakuim, aeroplanët për operacione psikologjike, helikopterët, fluturaket etj.)”, “Pajimi për desantin (mjetet standarde aeronautike, mjetet speciale për desantë, mjetet e diversantëve detar)”, “Mjetet e lidhjes”, “Pajimi personal i pjesëtarëve të njësiteve speciale” dhe “Uniforma dhe shenjat”.⁵⁰ Brenda kapitullit III. Art taktik, temat që ligjëroheshin ishin: “Aftësimi për luftimin konvencional”, “Aftësimi për luftimin jokonvencional”, “Operacionet speciale” dhe “Përkrahja e veprimeve speciale”.

⁴⁸ AIHP. F.UÇK-ZOLL 1998-1999. Kutia 1, Programi i ushtrimeve dhe edukimit luftarak të njësisve speciale të Zonës Operative të Llapit, 23. 0. 1999.

⁴⁹ Refik Jashari, intervistë me autorin, Prishtinë, 12 gusht 2024; Ismajl Revuçi, Ajet Potera, intervistë me autorin, Prishtinë, 10 gusht 2024.

⁵⁰ AIHP. F.UÇK-ZOLL 1998-1999. Kutia 1, Programi i ushtrimeve dhe edukimit luftarak të njësisve speciale të Zonës Operative të Llapit, 23. 0. 1999.

Ndërsa brenda temës “Aftësimi për luftimin konvencional nëntemat që ligjëroheshin ishin: “Kompletimi dhe bartja e armatimit, municionit dhe pajimi”, “Puna dhe veprimet e ushtarit në luftë”, “Lufta e afërt me mjetet e blinduara luftarake”, “Skuadra në sulm”, “Skuadra në mbrojtje”, “Skuadra në vëzhgim”, “Detyrat e skuadërkomanduesit në organizimin e sistemit dhe udhëheqjen e zjarrit të skuadrës”, “Mbrojtja kundërajrore me armatimin e këmbësorisë”, “Ushtrimet me orientim dhe lexim të hartës me marshim sipas azimutit”, “Skuadra-togu në sigurimin e prijesve ushtarakë në vend dhe lëvizje”, “Skuadra-togu në bastisje të territorit dhe objekteve”, “Skuadra-togu në kapjen e mjetit motorik në komunikacion”, “Skuadra-togu në sigurimin e komandës-entit dhe objekteve tjera, posaçërisht të ruajtura”, “Togu në sigurimin e regjioneve dhe drejtimeve të caktuara”, “Skuadra-togu në veprim në objekt”, “Togu-kompania në bllokimin dhe asgjësimin e njësitit diversantë - terrorist”, “Alarmi dhe gatishmëria luftarake (alarmi luftarak, alarmi mobilizues dhe alarmi në rastet e fatkeqësive elementare, zjarrit etj.)”. “Organizimi dhe përdorimi i sistemit të ndërlidhjes”, “Të ushqyerit në luftë”, “Pastrimi i ujit për pije” dhe “Lufta kundërelektronike”. Brenda temës “Aftësimi për luftë konvencionale”, nëntemat që ligjëroheshin ishin: “Lufta guerile”, “Mbijetesa”, “Subversionet”, “Sabotimet” dhe “Diversionet”. Brenda temës “Operacionet speciale” nëntemat që ligjëroheshin ishin: “Shërbimi informativ”, “Veprimi në objektet me rendësi strategjike”, “Shpëtimi”, “Veprimet antiterroriste dhe antikryengritëse”, “Format e veprimeve speciale”, “Sulmi i befasishëm”, “Pusia” dhe “Vrull zjarri”. Brenda temës “Përkrahja e veprimeve speciale” nëntemat që ligjëroheshin ishin: “Infiltrimi”, “Sigurimi informativ”, “Logjistika”, “Operacionet psikologjike dhe punët civile”.

Brenda kapitullit IV. Ushtrimet Rreshtore, nëntemat që ligjëroheshin ishin: “Përshëndetja dhe raporti në mes ushtarëve dhe eprorëve në UÇK”, “Veprimet rreshtore-qëndrimet pa armë”, “Veprimet rreshtore-qëndrimet me armë”, “Veprimet rreshtore të skuadrës”, “Veprimet rreshtore të togut” dhe “Veprimet rreshtore të kompanisë-baterisë”. Brenda kapitullit V. Ushtrimet e Xhenios, nën temat që ligjëroheshin ishin: “Fortifikimi sipas sistemit “NATO”, “Pengesat dhe mënyra e kalimit të tyre (kundër këmbësorisë dhe kundër mjeteve të blinduara)”, “Kalimi i pengesave ujore”, “Maskimi”, “Eksplozivët dhe mjetet djegëse me fitil”, “Minat (formacike dhe

doracake)”, “Shfrytëzimi i eksplozivit për rrënimin e objekteve dhe elementeve etj.” dhe “Asgjësimi i objekteve në mënyra të ndryshme pa eksploziv”.

Brenda kapitullit VI. Mbrojtja nga mjetet nukleare kimike dhe biologjike, nën temat që ligjëroheshin ishin: “Armatimi nuklear, kimik dhe biologjik” dhe “Zbulimi, masat mbrojtëse nga mjetet NKB dhe dekontaminimi”. Brenda kapitullit VII. Ushtrimet e Sanitetit, nën temat që ligjëroheshin ishin: “Masat themelore higjienike për ruajtjen e shëndetit”, “Ndihma e parë te të lënduarit dhe të sëmurit” dhe “Evakuimi i të lënduarve dhe të sëmurëve”. Brenda kapitullit VIII. Ushtrimet dhe stërvitjet fizike. Nëntemat që ishin ligjëruar ishin: “JUDO; rrotullimet, rëniet, blloqet dhe taktika e luftës në këmbë dhe parter”, “JIU-JICU; bllokimet e rënieve, llosat dhe qelëzat për shoqërim, mbrojtja nga thika, mbrojtja nga arma e zjarrit”, “KARATE; pozita për luftë dhe teknika e lëvizjes në luftë, teknika e rënies me dorë, këmbë dhe bllokimet e rënieve”, “Teknika e gjuajtjes së thikës dhe yjeve”, “Teknika e luftës me bajonetë”, “Teknika dhe normimi i kalimit të pengesave “NATO”, “Shumëgarshi: vrapimi në 100 m, në 1 500, kërcim së gjati, hedhja e bombës, hipja në litar dhe ngritja në duar” dhe “Verifikimi i aftësive fizike sipas normimit për Njësite Speciale”.

Brenda kapitullit IX. Alpinizmi, nëntemat që ligjëroheshin ishin: “Njohja e bjeshkëve, destinimi dhe shfrytëzimi i pajimit alpinistik”, “Teknika e ecjes dhe ngritjes”, “Ngritja në objektet e ndryshme”, “Lëshimi me litar”, “Ngritja nëpër “oxhak” dhe plasje të shkëmbit”, “Ngritja e grupit alpinistik dhe “Shpëtimi i të lënduarve - të plagosurve në bjeshkë”.⁵¹ Njësitet e artilerisë në ZOLL, gjatë fundvitit 1998 dhe fillimit të vitit 1999, kishin filluar të avancojnë si me pajisje dhe personel të stërvitur. Ndër armët që posedonin këto njësi ishin minahedhësit e kalibrit 120 mm dhe raketahedhësit të dorës 64mm m-80 “zola”. Me qëllim perfeksionimi në përdorim e këtyre armëve, sipas “Planit të përgatitjes së numërorëve dhe pjesëtarëve të tjerë të baterisë së minahedhësve të kalibrit 120 mm”, luftëtarëve iu ligjëroheshin tema, si: “Njësitë matëse në artileri”, “Puna në pozitën e zjarrit”, “Përgatitja e elementeve fillestare

⁵¹ AIHP. F.UÇK-ZOLL 1998-1999. *Kutia 1*, Programi i ushtrimeve dhe edukimit luftarak të njësiteve speciale të Zonës Operative të Llapit, 23. 0. 1999.

për qitje” dhe “Korrektura”.⁵² Ndërsa sipas “Rregullores së raketahedhësit të dorës 64mm m-80 “zola”, temat që ligjëroheshin ishin: “Destinimi dhe cilësitë luftarake”, “Përshkrimi i lansuesit”, “Puna e ushtarit dhe pjesëve të armës me rastin e kalimit nga marshimi në pozitën luftarake”, “Principi i veprimit komulativ të raketës”, “Masat e sigurisë me rastin e qitjes”, “Ndërprerjet dhe mënyra e mënjanimit”, “Ruajtja e raketahedhësit të dorës” dhe “Qitja në kushtet e kufizuara të pamjes”.⁵³

Gjatë luftës çlirimtare në ZOLL njësitet e vëzhgimit kishin një rol të rëndësishëm, andaj iu kushtua rëndësi e konsideruar në mësimin dhe trajnimin e tyre. Atyre përmes ligjëratave teorike, bazuar në manualin “Vëzhgimi në njësitet e këmbësorisë”, iu ligjëroheshin temat siç ishin: “Kush është vëzhguesi”, “Detyrat e vëzhguesit”, “Vëzhgimorja, kryerja e vëzhgimit dhe mënyra e kryerjes së vëzhgimit”.⁵⁴

Te luftëtarët e ZOLL-it gjatë trajnimit teorik dhe praktik, një kujdes dhe rëndësi iu kushtojë mësimëve mbi mënyrën praktike për caktimin e largësisë së caktut. Sipas manualit “Caktimi i largësisë deri te caqet dhe objektet e ndryshme në tokë”, luftëtarët mësonin se kusht themelor për kryerjen e detyrave të zjarrit dhe qitje precize nga armët është caktimi i saktë i largësisë deri në cak. Mënyra praktike për caktimin e largësisë (përveç me mjete teknike siç është matja me laser, instrumente, topografike etj.) është: “Caktimi i largësisë me sy”, “Matja direkte” dhe “Madhësia këndore”.⁵⁵

Rrugëtimit (trajektorës) të predhës në ajër dhe metodat e caktimit të madhësisë së elementeve të rrugës së tij ishin tema të përditshme ligjërimit për luftëtarët snajperistë. Bazuar në manualin “Bazat teorike të rregullave të qitjes”, temat që ligjëroheshin për snajperistët ishin: “Trajektorja dhe elementet e saj”, “Marrja në shenjë dhe elementet e shënjestrit”, “Hapësira korreë

⁵² AIHP. F.UÇK-ZOLL 1998-1999. Kutia 1, Plani i përgatitjes së numërorëve dhe të pjesëtarëve tjerë të baterisë së minahedhësve Kal. 120 mm, 26.01.1999.

⁵³ AIHP. F.UÇK-ZOLL 1998-1999. Kutia 1, .12; Kadri Kastrati, Nuredin Ibishi, Ismajl Revuçi, Ajet Potera, Refik Jashari, Musa Jakupi, Agron Berisha, bashkëbisedim me autorin, Prishtinë, korrik-gusht 2024.

⁵⁴ AIHP. F.UÇK-ZOLL 1998-1999. Kutia 1, Vëzhgimi në njësitet e Këmbësorisë, 04.02.1999.

⁵⁵ AIHP. F.UÇK-ZOLL 1998-1999. Kutia 1, Caktimi i largësisë deri te caqet dhe objektet e ndryshme në tokë, 03 nr. 10 datë 26.02.1999.

tokësore” dhe “Shpërndarja, goditja dhe mundësitë e goditjeve”.⁵⁶ Gjithashtu, sipas manualit “Marrja në shenjë me shkrepje me armatimin e këmbësorisë dhe bashkërenditja e të gjitha veprimeve për qitje”, mbajtja e armës gjatë kryerjes së qitjes, shkrepja e armës dhe bashkërenditja e të gjitha veprimeve për qitje ishin leksione për luftëtarët e UÇK-së në ZOLL.⁵⁷

Planet dhe programet si dhe zbërthimi i tyre në tema për orë të caktuara është argument se mësimi dhe edukim ishin të ngjeshur dhe sistematik për luftëtarët. Të gjitha ligjëratat teorike, detyrimisht praktikoheshin dhe ushtroheshin në poligonet e improvizuara, ku luftëtarët tregonin përkushtim dhe gatishmëri të lartë për perfeksionimin e tyre.

Organizimi i trajnimeve nga SHP i UÇK-së

Nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, mbi misionin, mbi detyrat dhe përgjegjësitë udhëheqëse dhe komanduese, planifikoheshin, organizoheshin dhe realizoheshin mësimi dhe edukimi i luftëtarëve në kurse dhe trajnime të ndryshme. Kurset dhe trajnimet organizoheshin pranë Shtabit të Përgjithshëm dhe në qendra trajnuese në kuadër të zonave të ndryshme operative. Edhe në këto kurse dhe trajnime ishte një gërshetim teorik-praktik.⁵⁸

Më 18 prill 1998, Akademia Ushtarake e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, filloi të organizonte kurse për oficerët e ardhshëm të UÇK-së.* Gjeneratës së luftëtarëve, të cilët morën pjesë nga data 20 nëntor 1998 - 28 shkurt 1999, iu ligjëruan: Tahir Sinani, strategji ushtarake, Fadil Zejnullahu, minim dhe deminim dhe Ajvaz Berisha, përgatitje fizike. Nga Zona Operative e Llapit, në këtë gjeneratë, kursin e kanë përfunduar me sukses luftëtarët: Bahri Selimi, Hysen Avdyli, Idriz Gashi, Fidaim Gashi, Naim Sekiraqa, Valon Vllasa, Ismail Toshi dhe Shkumbin Mehmeti.⁵⁹

⁵⁶ AIHP. *F.UÇK-ZOLL 1998-1999. Kutia 1*, Bazat teorike të rregullave të qitjes 03 nr. 12 datë 08.03.1999.

⁵⁷ AIHP. *F.UÇK-ZOLL 1998-1999. Kutia 1*, Marrja në shenjë me shkrepje me armatimin e këmbësorisë dhe bashkërenditja e të gjitha veprimeve për qitje.

^{58 58} Zhitia UÇK-ZOLL, 223.

* Më 18 mars të vitit 1998, në Açaevë të Drenicës ka filluar punën Akademia e parë Ushtarake e udhëhequr nga Bekim Berisha dhe Kadri Hamiti, ndërsa më 22 prill 1998, nga kjo Akademia dolën kadetët e parë të Akademisë Ushtarake të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

⁵⁹ Bahri Selimi, bashkëbisedim me autorin, tetor 2024. Kursi është mbajtur në Divjakë dhe

Në Nishur të Suharekës, Zona Operative e Pashtrikut, kursin për Komandant Batalioni e kishin përfunduar me sukses Naser Hyseni, Sami Revuçi dhe Faik Revuçi. Kursi për komandant batalioni kishte si qëllim përgatitjen e oficerit të shtabit të batalionit (ose ekuivalente), dhënien e njohurive në nivelin e brigadës, si dhe përzgjedhjen e oficerëve më të mirë për të vijuar si oficerë shtabi (komandant batalioni) në zonat prej nga vinin.⁶⁰

Në Likoc, Zona Operative e Drenicës, kursin për përdorimin e Shigjetës 2M e kishin përfunduar me sukses Fadil Begu, Misim Haziri dhe Remzi Zebica. Kursi për përdorimin e Shigjetës 2M ishte i një niveli të lartë të organizimit. Shigjeta 2M është një armë shumë efikase kundërajrore siç janë mjetet luftarake fluturuese, helikopterët dhe aeroplanët, me efekt deri në 5 km.⁶¹

Në Nishur të Suharekës, Zona Operative e Pashtrikut, në kursin për Operator të Ndërlidhjes morën pjesë Naser Ramadani dhe Gëzim Podvorica. Kursi i ndërlidhjes, i cili organizohej nga Drejtoria Operative e SHP të UÇK-së kishte për qëllim të ngritjes së nivelit dhe unifikimit të komandimit të udhëheqjes si dhe në përdorimin e mjeteve të ndërlidhjes, sipas rregullave taktike e teknike në të gjitha njësitë, komandat dhe shtabet e UÇK-së.⁶²

Stafi komandues në ZOLL në raport me luftëtarët (ushtar dhe epror) vullnetar u tregua i kujdesshëm, i ndërgjegjshëm dhe profesional. Në vazhdimësi, nga kyçja në radhët e UÇK-s në ZOLL luftëtarët iu përgjigjën trajnimeve përmes të cilave arritën të mësonin dhe edukoheshin në frymën ushtarake. Në ZOLL, mobilizimi dhe rekrutimi i luftëtarëve bëhej me kujdes dhe pas një verifikimi të personalitetit, si dhe rrethanave familjare, luftëtarët duhej të ishin në nivelin më të lartë të përkushtimit dhe gatishmërisë. Ushtria Çlirimtare e Kosovës në ZOLL, me rekrutimin e luftëtarëve, planifikoj organizoj dhe realizoj trajnime përgatitore, të cilat në kuadër të planeve dhe programeve kishin për qëllim përgatitjen psiko-fizike, taktike, operative dhe strategjike të luftëtarëve. Nisur nga kjo, ushtar dhe epror të UÇK-s në ZOLL u përgatitën mjaftueshëm gjë që e treguan humbjet e shumta të forcave serbe si në resurse njerëzore ashtu edhe pajisje tjera luftarake nëpër betejat e shumta gjithandej në territorin e zonës.

Kleçkë.

⁶⁰ Sami Revuçi dhe Faik Revuçi, Intervistë me autorin, Prishtinë, 15 gusht 2024.

⁶¹ Misim Haziri, intervistë me autorin, Prishtinë, 21 gusht 2024.

⁶² AIHP. *F.UÇK-ZOLL 1998-1999. Kutia 1*, Drejtoria Operative.

Ushtari i UÇK-s në ZOLL, mes tjerash u edukua t'i bindej pa hezitim dhe kundërshtim urdhreve të eprorit. Ushtari ishte shembull disipline për të gjithë njerëzit me të cilët kishte kontakt. Edukata e fituar i kaliti shpirtërisht dhe fizikisht për të mos u tërhequr nga pozicionet për asnjë qastë pa urdhër të eprorit. Ai tregoi solidaritet me bashkëluftëtarin qoftë edhe me rrezikimin e jetës së vet. Luftëtari nuk e konsideroi ofendim asnjë detyrë qofshin edhe fizike. Ai tregoi moral të lartë në raport me bashkëluftëtarin apo bashkëluftëtaren. Luftëtari ishte i disiplinuar në respektim të urdhreve dhe qëndrimeve në njësite, nuk mungonin në stërvitje dhe aktivitete tjera pa leje të eprorit. Luftëtari tregoi edukatë në biseda dhe analiza të luftimeve ndër beteja, nuk fuste përçarje dhe nuk krijoi grupacione partiake, ideore, fetare, krahinore etj. Raportimin tek eprori madhor e konsideroi obligim ushtarak dhe asnjëherë nuk dezinformoi që të shkaktonte panik në çfarëdo rrethanash.

Eprori i UÇK-s, mes tjerash u edukua të jetë i afërt me të gjithë ushtarët dhe të jetë shumë i drejtë, në detyra të jetë shumë i përpiktë, kurse në urdhra shumë i qartë, në aksione të jetë më i guximshmi dhe i pari, kurse në tërheqje i fundit. Të gjitha rregullat që ishin të vlefshme për ushtarin e thjesht njëkohësisht vlenin edhe për eprorin. Ata reflektuan besimin se në ushtri nuk ka të privilegjuar, prandaj eprori ishte shembull i respektimit të hierarkisë.

Luftëtari i UÇK-s në ZOLL, si ushtar dhe epror, ishte shembull i një personi vigjilent, të kujdesshëm dhe besnik, si në detyrën dhe përgjegjësinë para eprorit dhe bashkëluftëtarëve të vet. Luftëtarët e UÇK-s ndër beteja treguan vlerat mbi të cilat u kalitën dhe u bënë shembulli më i mirë i luftës dhe si sakrificës për atdheun. Ata me heroizmin e pashoq dhe me rëniet e tyre u bënë themel i lirisë dhe i shtetësisë së Kosovës.

Skënder ZHITIA

SUMMARY

THE PSYCHO-PHYSICAL PREPARATION AND MILITARY EDUCATION OF KLA FIGHTERS IN THE LLAP OPERATIONAL ZONE (1998-1999)

The Command Staff of Lap Operative Zone (LOZ) demonstrated exceptional care, conscientiousness, and professionalism in relation to volunteer fighters (both soldiers and officers). Continuously, as soon as they joined the Kosovo Liberation Army (KLA), at the LOZ, the fighters consistently responded to the training and were subjected to education and military discipline. The mobilization and recruitment of soldiers in the LOZ was conducted meticulously, through a careful evaluation of both their character and family background, ensuring they presented the highest level of devotion and willingness. The KLA LOZ, besides the recruitment, had planned, organized, and implemented preparatory training programs that were designed to enhance the psychological, physical, tactical, operational, and strategic capabilities of fighters. As a result, the KLA LOZ soldiers and officers were outstandingly prepared, a fact that was highlighted by considerable losses caused to Serbian forces both in personnel and military equipment throughout the numerous battles across the region.

The KLA LOZ soldiers, furthermore, were educated to obey orders of superiors without any hesitation or objection. Soldier represented a sample of discipline to all he/she came in touch with. The acquired discipline strengthened the soldier mentally and physically, ensuring he/she wouldn't abandon their positions under any condition without superiors' order. The soldier demonstrated cohesion to fellow fighters, even at the risk of his/her own life. No task, regardless of whether mentally or physically demanding, was ever considered an insult. The soldier maintained high moral standards in relation to fellow fighters, both male and female. The soldier showed discipline, following orders and adhering to unit protocols, and never lacked any training or activity without permission from a supervisor. The fighter

demonstrated exemplary conduct during conversations and battle analyses, avoiding any deed that could lead to a split or the creation of ideological, political, religious, or regional fractions. Reporting to the respective commanding officer was regarded as a military responsibility to a soldier, and under no condition, a soldier provided false information to incite a panic.

Besides other things, the KLA officer was trained to be approachable and fair to all soldiers, to be careful in conducting his/her duties, to transmit clear orders, to be brave and to lead the action, and to be the last to withdraw. All the rules that applied to a random soldier were equally applied to officers, reinforcing the belief that there were not privileged individuals within the army. Therefore, the officer was a model of adherence to the chain of command. The KLA LOZ fighter, whether a soldier or an officer, was a synonym of vigilance, care, and loyalty, both in fulfilling duties and responsibilities to their supervisors and fellow fighters. During the battles, the KLA fighters demonstrated a value that derived from their education, serving as the finest examples of the fight and sacrifice for the homeland. Through their incomparable heroism and ultimate sacrifice, they become the cornerstone of Kosovo's freedom and statehood.